

VENDIM
Nr. 657, datë 7.8.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR REALIZIMIN E PROCEDURËS SË
VEPRËS MONUMENTALE, SHTATORE KUSHTUAR FIGURËS HISTORIKE TË ISMAIL
QEMALIT, ME RASTIN E 100-VJETORIT TË PAVARËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, t’i shtohet fondi total prej 6 680 000 (gjashtë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) lekësh, për realizimin e procedurës së veprës monumentale, shtatore, kushtuar figurës historike të Ismail Qemalit me rastin e 100-Vjetorit të Pavarësisë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha